

## KOMUNA E FERIZAJT 2017: PROBLEMET KRYESORE DHE TRENDET BUXHETORE

### Hyrje

Kryetar i Komunës së Ferizajt është Muharrem Svarqa (LDK), për të cilin ky është mandati i tij i parë, i fituar pas zgjedhjeve të vitit 2013.

Mbi 82% e qytetarëve të Ferizajt konsiderojnë se komuna mund t'i zgjidh problemet me të cilat ballafaqohen ata.<sup>1</sup> Dy vite pas nisjes së mandatit të kryetarit Svarqa, 31% e qytetarëve janë shprehur të kënaqur me punën e tij, përderisa vetëm 15% e qytetarëve kanë konsideruar se fondet publike në komunë menaxhohen siç duhet.<sup>2</sup>

Në prag të zgjedhjeve komunale 2013, Instituti GAP kishte identifikuar pesë problemet kryesore të Komunës së Ferizajt. Ndër problemet më madhore ishin: reduktimet e shpeshta të ujit të pijes, mungesa e kanalizimeve në disa pjesë të qytetit, prerja e pyjeve, mungesa e trotuareve dhe mbikalimeve si dhe rrënimi i objekteve të trashëgimisë kulturore. Instituti GAP së bashku me organizatën Iniciativa për Progres (INPO) kanë zhvilluar një hulumtim për të parë nëse këto probleme janë evituar pas zgjedhjeve lokale të nëntorit 2013 duke listuar njëherazi problemet më të mëdha me të cilat përballet aktualisht kjo komunë.<sup>3</sup>

<sup>1</sup> UNDP, Mozaiku i Kosovës 2015, faqe 37. Burim: <http://bit.ly/2wkuTnr>

<sup>2</sup> UNDP, Mozaiku i Kosovës 2015, faqe 91-92. Burim: <http://bit.ly/2wkuTnr>

<sup>3</sup> Instituti GAP. Problemet Kryesore dhe trendet buxhetore të Komunës së Ferizajt 2013. Burimi: <http://bit.ly/2nhTjH> (qasur me 18.05.2017).

## Problemet aktuale të Komunës së Ferizajt

### Mungesa e lokacionit për deponi të mbeturinave

Komuna e Ferizajt akoma nuk ka të caktuar një lokacion që do të shërbejë si deponi mbeturinash. Përveç mungesës së deponisë, menaxhimi i mbeturinave nuk është në gjendje të mirë as në qytet. Në disa vendbanime vërehen grumbuj mbeturinash të cilat japin një pamje jo të mirë për qytetin. Kjo veçmas në rrugën që lidh fshatrat Zaskok-Doganaj, në rrugën e qytetit "Kadri Zeka", gjithashtu afër shkollës fillore "Gjon Serreçi".<sup>4</sup>

### Mungesa e sinjalistikës dhe pengesave afër hekurudhës

Gjatë vitit 2017 kanë ndodhur tri aksidente, dy prej tyre me fatalitet, në afërsi të hekurudhës që përkrah qendrën e qytetit. Për mungesën e sinjalistikës, komuna e hedh përgjegjësinë tek ndërmarrja publike për menaxhimin e hekurudhave "Infrakos", ndërsa këta të fundit përgjegjës e bëjnë komunën për mos vendosjen e shenjave dhe pengesave të tilla. Në fushatën zgjedhore të nëntorit 2013, kryetari aktual pati premtuar marrjen e masave që parandalojnë aksidentet në afërsi të hekurudhës, por përgjatë këtyre katër viteve ky problem nuk është evituar.

### Prerja ilegale e pyjeve

Dëmtimi i pyjeve nga prerja ilegale e tyre vlerësohet problem i madh në Komunën e Ferizajt. Ky problem ka figuruar edhe në mesin e problemeve të cekura në fund të 2013. Kjo dukuri është më e theksuar veçmas në zonën e ashtuquajtur brezi i maleve të Jezercit, vargu i maleve të Sharrit në drejtim të Shtërpcës si dhe vargmalet e Zhegocit.

### Mungesa e parkingjeve për vetura në qytet

Komuna e Ferizajt hyn në mesin e komunave që ka mungesë të theksuar të parkingjeve për vetura. Sipas raportit të MAPL për performancën e komunave, Ferizaj ka vetëm dy lokacione të parkingjeve me kapacitet prej 130 veturave. Brenda qytetit vërehen disa oborre të cilat qytetaret i kanë hapur për t'i shndërruar në parkingje private. Prezenca e madhe e veturave të parkuara vend e pa vend i japin qytetit një pamje jo të mirë dhe po ashtu në disa vendbanime shfrytëzohen trotuaret për parking të veturave duke bërë kështu që këmbësoret të lëvizin rrugës se paraparë për automjete.

### Mungesa e shërbimeve shëndetësore në fshatra

Në disa fshatra të Ferizajt, veçmas në Nerodime dhe në fshatin Koshare ka mungesë të shtëpive të shëndetit. Banoret e këtyre fshatrave për një shërbim sa do elementar shëndetësor duhet të udhëtojnë në qytet.

---

<sup>4</sup> Problemet nëpër komuna janë listuar bazuar në intervista të drejtpërdrejta me përfaqësues komunal, të partive politike, shoqërisë civile, mediave dhe njohëseve të zhvillimeve lokale.

### **Mungesa e rrjetit të ujësjellësit në fshatra**

Komuna e Ferizajt është njëra ndër komunat që ka përfituar me se shumti nga fondet zvicerane për zgjidhjen e problemit të ujit të pijes. Përkundër kësaj, shumë fshatra të kësaj komune janë pa rrjet të ujësjellësit, siç janë fshatrat: Greme, Manastric, Komogllavë, Zllatar, Mirosalë, Bibaj, Kosinë, Prelez i Muhaxhirëve dhe Mohoc.

### **Shtrirja e rrjetit të kanalizimit nëpër fshatra**

Nga 43 fshatra sa ka gjithsejtë Ferizajt, 31 prej tyre nuk kanë rrjet të kanalizimit. Banorët kryesisht kanë bërë zgjidhje duke hapur gropa jo larg vendbanimeve të tyre ku derdhen kanalizimet e instaluara privatisht. Kjo për veç përhapjes së erërave të këqija, përhapjes së insekteve, përcillet edhe me rrezikun e rënies së fëmijëve në gropat e hapura. Në mesin e fshatrave që nuk kanë rrjet të kanalizimit janë: Mohoc, Kosinë, Komogllavë, Sojevë, Gaçkë, Greme, Nerodime, etj.

## **Trendet buxhetore të komunës**


Komuna e Ferizajt në vitin 2017 ka planifikuar 26.5 milion euro buxhet.<sup>5</sup> Përveç të hyrave të rregullta, nga viti i kaluar janë bartur të hyra vetanake me vlerë rreth 1.6 milionë euro, ndërsa në vitin 2013 ishin bartur rreth 981 mijë euro. Krahasuar me vitin 2013, Komuna e Ferizajt ka pasur një rritje prej 5.7 milionë euro të buxhetit (28%). Kjo kryesisht për shkak të rritjes së transfereve qeveritare mirëpo edhe një rritje të lehtë në planifikimin e të hyrave vetanake.

Për paga në 2013 janë ndarë rreth 11.1 milionë euro, përderisa në 2017 ky buxhet është për 3.3 milionë euro më i lartë, ndërsa në kategorinë e investimeve kapitale në 2013 Ferizajt ka ndarë 6.9 milionë euro ndërsa në 2017 janë ndarë 8.1 milionë euro.

---


<sup>5</sup> Shih për më shumë platformën buxhetore të Institutit GAP në <http://bit.ly/2rMELbD>

**Figura nr.1:** Trendët buxhetore në Ferizaj 2011 – 2017




Në bazë të grafikonit shohim se Komuna e Ferizajt vazhdimisht ka pasur një dominim të shpenzimeve në paga dhe trendi ka shkuar në rritje për 3.2 milionë euro (29%). Krahasuar me vitin 2013, edhe investimet kapitale kanë shënuar ngritje në 2017 për 1.2 milionë euro (17%).

**Figura nr.2:** Përqindja e investimeve kapitale dhe pagave



Ndërsa sa i përket të hyrave vetanake buxhetore, Komuna e Ferizajt në vitin e fundit (2016) ka pasur rreth 4.2 milionë euro të hyra vetanake, apo rreth 687 mijë euro më shumë se në vitin 2015. Kategoria kryesore e të hyrave në Ferizaj mbetet ajo e tatimit në pronë, prej nga në vitin 2016 janë mbledhur rreth 1.6 milionë euro.

**Figura nr.3:** Të hyrat vetanake të komunës 2013-2016



## Rekomandimet

Duke u bazuar në problemet kryesore, fushat të cilat kërkojnë vëmendjen e Komunës dhe trendët buxhetore, Instituti GAP rekomandon që qeverisja e komunës e dalë nga zgjedhjet lokale të 2017 të ndërmerr këto veprime:

- Komuna e Ferizajt duhet ta konsiderojë me prioritet gjetjen e lokacionit i cili do të mund të shfrytëzohet për deponi të hedhjes së mbeturinave.
- Komuna e Ferizajt duhet të marr masa në rritjen e sigurisë përkaj hekurudhës.
- Të ndërmerren masa për parandalimin e prerjes ilegale të pyjeve.
- Komuna e Ferizajt duhet të nis hartimin e planeve për të zgjidhur problemin e mungesës së parkingjeve në qytet.
- Komuna e Ferizajt duhet të nis shpërndarjen e shërbimeve shëndetësore edhe në fshatra.

INSTITUTI GAP  
GAP INSTITUTE



Instituti për Studime të Avancuara GAP është një Think-Tank i themeluar në tetor të 2007 në Kosovë. Qëllimi kryesor i GAP-it është të tërheq profesionistë për të krijuar një ambient të zhvillimit dhe hulumtimit profesional, që haset në institucione të ngjashme në shtetet perëndimore. Kjo gjithashtu u ofron mundësi kosovarëve për hulumtimin, zhvillimin dhe implementim e projekteve me qëllim të avancimit të shoqërisë kosovare. Prioritet për këtë Institut është mobilizimi i profesionistëve në adresimin e sfidave ekonomike, politike dhe sociale të vendit. Qëllimet kryesore të GAP-it janë të mbush zbrazëtitë në mes të qeverisë dhe qytetarëve, si dhe të mbushë zbrazëtitë në mes të problemeve dhe zgjidhjeve.

**Ky projekt mbështetet nga:**



**National Endowment  
for Democracy**

*Supporting freedom around the world*